



Në bazë të nenit 40.2 (d) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale dhe nenit 26 pika 4 të Statutit të Komunës së Deçanit, Kuvendi i Komunës së Deçanit në mbledhjen e vet të mbajtur me dt.29.01.2021, bie këtë:

## V E N D I M

### MBI APROVIMIN E PLANIT TË PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS SË DEÇANIT PËR VITIN 2021

#### Neni 1.

Aprovohet Plani i punës së Kuvendit të Komunës së Deçanit për vitin 2021, si në tabelën e paraqitur më poshtë:

Janar	<ol style="list-style-type: none"><li>1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Planit të punës së Kuvendit për vitin 2021,</li><li>2. Marrja e Vendimit për mbajtjen e mbledhjeve të rregullta dhe mbledhjeve publike të Kuvendit dhe të KPF-së për vitin 2021,</li><li>3. Shqyrtimi dhe aprovimi i Planit të punës së Komitetit të Komuniteteve për vitin 2021,</li><li>4. Shqyrtimi dhe aprovimi i Planit të punës së Zyrës për komunitete dhe Kthim dhe Integritet Evropiane për vitin 2021,</li><li>5. Marrja e vendimit për Pëlqimin Mjedisorë për Raportin e Vlerësimit Strategjik Mjedisorë të PZHK-së,</li><li>6. Shqyrtimi dhe miratimi i Projekt-Rregullores për përkujdesjen dhe mbrojtjen e fëmijës,</li><li>7. Shqyrtimi dhe miratimi i Projekt-Rregullores për Institucionet Edukativo-Arsimore të Komunës së Deçanit ,</li><li>8. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Integritetit,</li></ol>	
-------	--	--

	<p>për vitin 2019,</p> <p>10. Shqyrtimi dhe aprovimi i Planit të Veprimit kundër korrupsionit,</p> <p>11. Formimi i Komisionit për përzgjedhjen e Drejtorëve/Zëvendësdrejtorëve të shkollave në Komunën tonë.</p>	
Shkurt	1.Orientimi I të hyrave vetanake të bartura nga viti 2020 në vitin 2021.	
Mars	1.Shqyrtimi I raportit analitik financiar për vitin 2020.	
Prill	1.Shqyrtimi I raportit financiar për periudhën Janar- 31 Mars 2021.	
Maj	1. Trajtim I rregulloreve komunale .	
Qershor	<p>1. Shqyrtimi I draftit të parë të Kornizës Afatmesme Buxhetore (KAB) 2022-2024,</p> <p>2. Shqyrtimi dhe aprovimi I Rishikimit të buxhetit për vitin 2021,</p> <p>3. Mbledhja e I-rë Publike për vitin 2021.</p>	<p>Diskutim publik me qytetar</p> <p>Për Kornizën Afatmesme Buxhetore 2022-2024.</p>
Korrik	<p>1.Raporti gjashtëmuor I Kryetarit të Komunës,</p> <p>2.Shqyrtimi I raportit gjashtëmuor financiar,</p> <p>3.Marrja e Vendimit për pushim vjetor të anëtarëve të Kuvendit.</p>	
Gusht	Pushim	
Shtator	<p>1. Shqyrtimi dhe miratimi I Buxhetit për vitin 2022.</p> <p>2. Shqyrtimi dhe miratimi I Rregullores mbi Tatimin në pronë për vitin 2022.</p>	

Nëntor	1. Shqyrtimi I raportit të Auditorit të Jashtëm.	
Dhjetor	1. Shqyrtimi I Raportit vjetorë të Kryetarit të Komunës. 2. Mbledhja e II-të Publike për vitin 2021.	

Neni 2.

Kuvendi i Komunës përveç pikave të paraqitura nga neni 1. i këtij vendimi gjatë vitit 2021 do të shqyrton edhe çështje tjera sipas nevojës dhe kërkesës së Ekzekutivit të Komunës.

Neni 3.

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Kryesuesi i Kuvendit të Komunës dhe Shërbimi Profesional për Punë të Kuvendit dhe Ekzekutivit.

Neni 4.


Vendimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit dhe 15 dit pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale , si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen e Komunës.

01.Nr.I-2

Deçan,dt.29.01.2021

KUVENDI I KOMUNËS SË DEÇANIT

Kryesuesi i Kuvendit:  
Haki Shehaj





Në bazë të nenit 39.4 të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës së Deçanit në mbledhjen e vet të mbajtur me dt.29.01.2021, bie këtë:

## V E N D I M

### PËR CAKTIMIN E ORARIT TË MBAJTJES SË MBLEDHJEVE TË RREGULLTA DHE PUBLIKE TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË DEÇANIT DHE MBLEDHJEVE TË KPF-së PËR VITIN KALENDARIK 2021

#### Neni 1.

Caktohet orari i mbajtjes së mbledhjeve të rregullta dhe mbledhjeve publike të Kuvendit të Komunës së Deçanit, si dhe mbledhjeve të KPF-së për vitin kalendarik 2021.

#### Neni 2.

Kuvendi i Komunës së Deçanit do të mbajë mbledhjet e rregullta në fund të çdo muaji.

#### Neni 3.

Kuvendi i Komunës së Deçanit do të mbajë së paku 2(dy) mbledhje publike dhe ato me dt. 17 Qershor dhe me dt.16 Dhjetor.

#### Neni 4.

Komiteti për Politikë dhe Financa do të mbajë mbledhjet e veta të rregullta 3 ditë para mbledhjeve të Asamblesë.

#### Neni 5.

Kuvendi i Komunës dhe Komiteti për Politikë dhe Financa mund të mbajnë edhe mbledhje tjera të rregullta jashtë këtij orari sipas nevojave dhe kërkesave të paraqitura.

#### Neni 6.

Për mbajtjen e mbledhjeve të rregullta anëtarët e Kuvendit dhe KPF-së do të njoftohen së paku 7 ditë pune para datës së mbajtjes së mbledhjes, ndërsa mbledhjet publike do të publikohen së paku 2 javë para takimit.

#### Neni 7.


Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Kryesuesi i Kuvendit të Komunës dhe Shërbimi Profesional për Punë të Kuvendit dhe Ekzekutivit.

#### Neni 8.

Vendimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit dhe 15 dit pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale , si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen e Komunës.

01.Nr.I-3

Deçan,dt.29.01.2021 KUVENDI I KOMUNËS SË DEÇANIT

	REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA E DEÇANIT Kuvendi i Komunës së Deçanit
K.K.Deçan AS	3556
01	04.02.21



Kryesuesi i Kuvendit  
Haki Shehaj



Në bazë të nenit 12, nenit 17 shkronja (b), nenit 40 paragrafi 40.2 shkronja (1) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr. 03/L-040, ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" dt. 28 qershor 2008), nenit 10 paragrafi 2 të Ligjit për Planifikim Hapësinor Nr. 04/L-174, ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" dt. 23.08.2013), si dhe nenit 6 paragrafi 1.4 nënparagrafi 1.4.1 të Udhëzimit Administrativ Nr. 11/2015 mbi Elementet dhe Kërkesat Themelore për Hartimin, Zbatimin dhe Monitorimin e Planit Zhvillimor Komunal, nenit 26 pika 5 të Statutit të Komunës së Deçanit, 01 Nr. IX-5 datë 31. 10. 2019, Kuvendi i Komunës së Deçanit, në mbledhjen e mbajtur me datë 29.01.2021, merr këtë:

## VENDIM PËR PËLQIMIN MJEDISORË PËR RAPORTIN E VLERËSIMIT STRATEGJIK MJEDISORË TË PZHK-së

### Neni 1

Merret Vendimi për Pëlqimin mjedisorë për raportin e vlerësimit strategjik mjedisorë të Planit Zhvillimor Komunal (PZHK) të Komunës së Deçanit.

### Neni 2

#### Qëllimi i hartimit

Pjesa e hyrjes së PZHK-së përfshinë Vendimin për Pëlqimin mjedisorë për raportin e vlerësimit strategjik mjedisorë (VSM). Vlerësimi Strategjik Mjedisorë zhvillohet gjatë tërë procesit të hartimit të Planit Zhvillimor Komunal. Përmes këtij raporti, respektivisht krahasimeve me objektivat e tij, vlerësohen ndikimet në mjedis të propozimeve të PZHK-së, qëllimet dhe objektivat, skenarët e propozuar mjedisorë si dhe veprimet.

Përmes VMS-së respektivisht masave zbutëse të saj tentohet që ndikimet negative mjedisore të evitohen, reduktohen ose kompenzohen me ndonjë element tjetër pozitiv mjedisorë.

### Neni 3

#### Subjekti përgjegjës për implementim

Drejtorati për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit është përgjegjës për implementimin e këtij vendimi.

### Neni 4

Vendimi hynë nga dita e Miratimit nga Kuvendi i Komunës dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga MAPL-ja 15 ditë, pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe publikimit në Ueb faqen zyrtare të Komunës.

**01.Nr. I-6**

**Deçan, dt. 29.01.2021**

	REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIC OF KOSOVA REPUBLIKA KOSOVA KOMUNA E DEÇANIT MUNICIPALITY OF DEÇAN OPSTINA DEÇAN
K.K. Deçan AS	3548
01	04.02.21



Kryesuesi i Kuvendit:  
Haki Shehaj



Sipas kërkesës së parashtruar nga Fehmi Dervishaj me nr. te protokollit 2749, në mbështetje te nenit 6 paragrafi 6.3 të Udhëzimit Administrativ nr.41/2006 dt.27.12.2006 për Ndërrimin e Destinimit të Pronës Bujqësore, sipas nenit 15 të Ligjit për Planifikim Hapësinor nr.04/L-174, nenit 13.1 (a) të Ligjit për Ndërtim Nr.02/L-26, nenit 40 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe në bazë të nenit 26 të Statutit të Komunës së Deçanit, Kuvendi i Komunës së Deçanit në mbledhjen e vet të mbajtur me dt.29.01.2021, merr këtë:

## VENDIM PËR NDËRRIMIN E DESTINIMIT TË TOKËS BUJQËSORE NË TOKË NDËRTIMORE

### I.

Merret VENDIMI për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore me qëllim të ndërtimit – Objekt afarist për ushtrimin e biznesit familjarë, në parcelën kadastrale Nr.0528-3 me kulturë livadh i klasit të 5-të me sipërfaqe 444 m<sup>2</sup> dhe në parcelën kadastrale Nr.0528-4, me kulturë livadh i klasit të 5-të, me sipërfaqe 426 m<sup>2</sup> e evidentuar në emër të pronarit Fehmi Dervishaj, Zona Kadastrale Isniq Komuna Deçan.  
Sipërfaqja e përgjithshme për ndërrim të destinimit është 870 m<sup>2</sup>.

### II.

Për procedurat e zbatimit të këtij vendimi do të kujdesen: Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër dhe Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim Hapësinorë dhe Mbrojtje të Mjedisit të Komunës së Deçanit .

### III

Vendimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit dhe 15 dit pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale , si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në web faqen e Komunës.

### VI.

Me nga një kopje të Vendimit paisen: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim Hapësinorë dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër dhe Arhivi i Komunës së Deçanit.

01.Nr.I-13/2

Deçan,dt.29.01.2021



Kryesuesi i Kuvendit:  
Haki Shehaj

Kryetari i Komunës	
K.K. Deçan As	
3547	
Nr. ftoçeve	01
Br. strah. 03	04.02.21
No. pages	



Në mbështetje të nenit 40.2 (c) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale dhe nenit 26 pika 3. të Statutit të Komunës së Deçanit, Kuvendi i Komunës së Deçanit në mbledhjen e mbajtur me dt.29.01.2021, merr këtë:

## V E N D I M

### PËR LEJIMIN E MJETEVE FINANCIARE PËR KOMPENZIMIN E STAFIT TË MJEKËVE DHE INFERNIERËVE PËR PUNËN E KRYER GJATË PANDEMISË COVID 19

- I. Lejohen mjetet financiare për kompenzimin e mjekëve dhe infermierëve të cilët punojnë në QKMF në Deçan me kontratë në vepër , të cilët kanë punuar gjatë kohës së pandemisë Covid 19, por nuk janë përfshi në pakon emergjente të Qeverisë së Kosovës, njejtë si kolegët e vet të cilët janë paguar nga buxheti I qeverisë. Duke u nisur nga ky fakt Kuvendi vendosi që këta mjek dhe infermier të kompenzohen për muajtë Shtator, Tetor, Nentor dhe Dhjetor, njejtë si koleget e tyre që janë ne liste te pagave.Vlera e mjeteve te miratuara është 7550 €. Mjetet financiare do të derdhen në xhirollogaritë e secilit veç e veç, sipas listës së përfituesve që do ti bashkangjitet këtij vendimi .
- II. Mjetet financiare, si në pikën I. të këtij vendimi ndahen nga mjetet buxhetore të Kujdesi Primar Shëndetësor-kodi buxhetor 73900, në kategorinë Mallra&Shërbime.
- III. Për realizimin e këtij vendimi do të kujdesen: Kujdesi Primar Shëndetësor dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa e KK Deçan.
- IV. Vendimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit dhe 15 dit pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale , si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në web faqen e Komunës.
- V. Me vendim njoftohen: Kujdesi Primar Shëndetësor, Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Arhivi i KK Deçan.

### KUVENDI I KOMUNËS SË DEÇANIT

01.Nr.I-13/1  
Deçan, dt.29.01.2021



Kryesuesi i Kuvendit:  
Haki Shehaj

	01.Nr.I-13/1	3558
	01	04.02.21



Në bazë të nenit 40 paragrafi 40.2 germa e) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040 dhe nenit 26 pika 9 të Statutit të Komunës së Deçanit, bazuar në Udhëzimin Administrativ (MASHT) Nr.151/2020 për Detyrat dhe Përgjegjësitë e Drejtorit dhe Zëvendësdrejtorit të Institucionit Publik Edukativo Arsimit dhe Aftësues Parauniversitar në Republikën e Kosovës, Procedurat e zgjedhjes dhe Emërimit, Përfundimit të kontratës dhe Emërimit të Përkohshëm, neni 6 pika 3.1, Kuvendi i Komunës së Deçanit në mbledhjen e vet të mbajtur me dt.29.01.2021, nxjerrë këtë:

## V E N D I M

### PËR EMËRIMIN E ANËTARËVE TË KOMISIONIT PËR PËRZGJEDHJEN E DREJTORËVE DHE ZËVENDËSDREJTORËVE TË SHKOLLAVE NË KOMUNËN E DEÇANIT

#### I.

Me këtë vendim bëhet emërimi i anëtarëve të Komisionit për zgjedhjen e Drejtorëve dhe Zëvendësdrejtorëve të shkollave në Komunën e Deçanit, për vitin shkollor 2020/2021, në këtë përbërje:

1. Xhevat Bozhdaraj-DKA-Udhëheqës i Sektorit të Arsimit,
2. Burim Bruqi-Kryetar i Këshillit të prindërve në nivel Komune.

#### II.

Komisioni është përgjegjës për zhvillimin e procedurës së rekrutimit të Drejtorëve dhe zv.Drejtorëve të shkollave në Komunën e Deçanit konform procedurave të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ(MASHT) Nr.151/2020.

#### III.

Për zbatimin e këtij Vendimi kujdeset Drejtoria për Arsim.

#### IV.

Vendimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit dhe 15 dit pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale , si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen e Komunës.

#### V.

Me Vendim paisen të përmendurit në pikën I. Të Vendimit, Drejtoria për Arsim, Kryetari i Komunës dhe Arhivi.

01.Nr.I-12

Deçan,dt.29.01.2021

KUVENDI I KOMUNËS SË DEÇANIT

Kryesuesi i Kuvendit:

Haki Shehaj

	REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA E DEÇANIT Kuvendi i Komunës së Deçanit
K.K. Deçan AS	3553
01	04.02.21



Në bazë të nenit 40.2 (d) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale dhe nenit 26 pika 4 dhe nenit 52 të Statutit të Komunës së Deçanit, Kuvendi i Komunës së Deçanit në mbledhjen e vet të mbajtur me dt.29.01.2021, bie këtë:

## V E N D I M

### MBI APROVIMIN E PLANIT TË PUNËS SË KOMITETIT TË KOMUNITETEVE PËR VITIN 2021

Neni 1.

Aprovohet Plani i punës së Komitetit të Komuniteteve të Kuvendit të Komunës së Deçanit për vitin 2021.

Neni 2.

Komiteti i Komuniteteve përveç çështjeve të paraqitura në planin e punës, gjatë vitit 2021 do të shqyrton edhe çështje tjera sipas nevojës dhe kërkesave që do të paraqiten.

Neni 3.

Pjesë përbërse e këtij Vendimi është Plani i punës së Komitetit të Komuniteteve për vitin 2021.

Neni 4.

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Kryesuesi i Kuvendit të Komunës dhe Zyra për Komunitete dhe Kthim dhe Integritime Evropiane e Komunës së Deçanit.

Neni 5.


Vendimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit dhe 15 dit pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale , si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen e Komunës.

01.Nr.I-4

Deçan,dt.29.01.2021

KUVENDI I KOMUNËS SË DEÇANIT

Kryesuesi i Kuvendit:  
Haki Shehaj





Në bazë të nenit 40.2 (d) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale dhe nenit 26 pika 4 dhe nenit 67 të Statutit të Komunës së Deçanit, Kuvendi i Komunës së Deçanit në mbledhjen e vet të mbajtur me dt.29.01.2021, bie këtë:

## V E N D I M

### MBI APROVIMIN E PLANIT TË PUNËS SË ZYRËS PËR KOMUNITETE DHE KTHIM DHE INTEGRIME EVROPIANE PËR VITIN 2021

#### Neni 1.

Aprovohet Plani i punës së Zyrës për Komunitete dhe Kthim dhe Integritime Evropiane të Komunës së Deçanit për vitin 2021.

#### Neni 2.

Zyra për Komunitete dhe Kthim dhe Integritime Evropiane përveç çështjeve të paraqitura në planin e punës, gjatë vitit 2021 do të shqyrton edhe çështje tjera sipas nevojës dhe kërkesave që do të paraqiten.

#### Neni 3.

Pjesë përbërse e këtij Vendimi është Plani i punës së Zyrës për Komunitete dhe Kthim dhe Integritime Evropiane për vitin 2021.

#### Neni 4.

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Kryetari i Komunës dhe Zyra për Komunitete dhe Kthim dhe Integritime Evropiane e Komunës së Deçanit.


#### Neni 5.

Vendimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit dhe 15 dit pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale , si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen e Komunës.

01.Nr.I-5

Deçan,dt.29.01.2021

KUVENDI I KOMUNËS SË DEÇANIT



Kryesuesi i Kuvendit:  
Haki Shehaj